



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Anketa e Kreditimit Bankar

## Numër 6

P R I L L 2 0 2 1

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin**

Numër 6

**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike  
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike**

[economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

## Përmbajtja

<b>Anketa e Kreditimit Bankar</b> .....	4
Hyrje .....	4
Përmbledhja e rezultateve .....	4
Kutia 1. Metodologjia .....	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi.....	8
Kreditë ndaj ndërmarrjeve .....	8
Standardet kreditore .....	8
Kushtet dhe rregullat.....	9
Kërkesa për kredi.....	10
Kreditë ndaj ekonomive familjare .....	11
Standardet kreditore .....	11
Kushtet dhe rregullat.....	11
Kërkesa për kredi.....	12
Financimi .....	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar .....	14
<b>Pritjet për Inflacionin</b> .....	16
Metodologjia .....	16
Përmbledhja e rezultateve .....	16

## Anketa e Kreditimit Bankar

### Hyrje<sup>1</sup>

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2020, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e parë të vitit 2021.

Përveç pyetjeve standarde, në këtë anketë u shtuan edhe disa pyetje mbi ndikimin e krizës pandemike dhe shëndetësore mbi ofertën kreditore të sektorit bankar në vend, rrezikun kryesor të perceptuar nga bankat, si dhe ndikim që kishin skemat lehtësuese të ndërmarra për menaxhimin e krizës pandemike.

### Përmbledhja e rezultateve<sup>2</sup>

**Oferta kreditore është lehtësuar si dhe kërkesa për kredi ka shënuar rritje deri në një masë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020.** Këto zhvillime i atribuohen lehtësimit deri në një masë të masave parandaluese për përhapjen e virusit Covid-19, si dhe vizitës dhe ndihmës financiare nga diaspora. Masat lehtësuese të ndërmarra nga institucionet e vendit për zbutjen e ndikimit të pandemisë në ekonomi, si dhe zbulimi i vaksinës kundër virusit dhe fillimi i vaksinimit në rajon dhe më gjerë diktuan pritjet e bankave, duke ndikuar në lehtësim të ofertës kreditore dhe rritje të kërkesës kreditore gjatë tremujorit të parë 2021.

**Kreditë e reja për ndërmarrjet gjatë tremujorit të katërt kishin rritje të lehtë krahas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, të ndikuara pozitivisht si nga oferta ashtu edhe nga kërkesa kreditore. Gjithashtu, pritjet e bankave për tremujorin vijues vazhdojnë të jenë optimiste.** Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar deri në një masë standardet e aplikuar gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi në tremujorin e katërt të vitit 2020 edhe pse me një indeks të ulët pozitiv. **Standardet kreditore u lehtësuan** në nivel të përafërt për të dy segmentet e ndërmarrjeve (NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha).. Oferta kreditore u ndikua pozitivisht kryesisht nga rritja e optimizimit për shkak të lehtësimit të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 dhe zbulimi i vaksinës kundër virusit, pastaj mbështetja e kredive nga FKGK, përmirësimi i perspektivës në tregjet globale, si dhe masat ndihmëse të qeverisë e lehtësimet rregullative të BQK-së siq janë ristrukturimet e kredive. Me gjithë deklaratat e bankave për lehtësim të standardeve kreditore, bankat listuan edhe faktorë që ndikuan negativisht në standardet kreditore edhe pse në nivel të ulët, e që është rritja e rrezikut kreditor në vend dhe jashtë tij.

Për tremujorin e parë të vitit 2021, pritjet e bankave konsistojnë kryesisht në lehtësimin tutje të standarde kreditore. Oferta kreditore deri në një masë pritet të jetë më e favorshme për NVM-të se

<sup>1</sup> Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

<sup>2</sup> Pyetësi dhe seria kohore e rezultateve të AKB-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

sa për ndërmarrjet e mëdha. Pritjet e bankave bazohen në pritjet për rimëkëmbjen e ekonomisë në vend, si rezultat i lehtësimit të masave kufizuese në kombinim me masat lehtësuese të ndërmarra nga autoritetet në vend për menaxhimin e efekteve të krizës pandemike. Gjashtë prej bankave pjesëmarrëse, presin që mbështetja e FKGK-së për NVM-të do të ndikojë në lehtësim të standardeve. Gjithashtu, kontribut pozitiv pritet të ketë edhe nga perspektiva e mirë e tregut bankar në vend, rritja e tolerancës ndaj rrezikut, si dhe në një nivel më të ulët nga rritja e presioneve të konkurrencës dhe ndryshimeve në lehtësimet rregullative. Njëkohësisht, sa i përket maturitetit bankat pritet të ofrojnë standarde kreditore të lehtësuara, ku për kreditë afatgjata lehtësimet pritet të jenë në një nivel më të lartë.

**Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan në nivel më të ulët.** Kushte dhe rregulla të lehtësuara u aplikuan për të dy segmentet e ndërmarrjeve, kryesisht përmes uljes së normës së interesit, ndërsa për NVM-të lehtësime kishte edhe në rritjen e shumës së kredisë. Faktorët që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave deri në një masë, ishin mbështetja e NVM-ve nga FKGK, rënia e rrezikut të perceptuar bazuar në përmirësimin e perspektivës së tregut në vend në përgjithësi dhe atij bankar në veçanti, si dhe rritja e presioneve të konkurrencës dhe lehtësimi i masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Përderisa, rritja e rrezikut kreditor vazhdoi të jetë faktor me kontribut negativ në kushtet dhe rregullat e ofruara nga bankat. Ndërkohë, për tremujorin e parë të vitit 2021, bankat presin lehtësime të kushteve dhe rregullave për të dy segmentet e ndërmarrjeve, ndërsa lehtësime më të theksuara pritet të ketë për NVM-të. Lehtësimet pritet të aplikohen kryesisht përmes uljes së normave të interesit, uljes së kërkesave për kolateral, si dhe në nivel më të ulët rritjes së shumës së kredisë e zgjatjes së maturitetit të kredive.

Gjatë tremujorit të katërt 2020, **kërkesa e ndërmarrjeve për kredi** bankare rezultoi të jetë rritur edhe pse në nivel më të ulët në krahasim me tremujorin paraprak. Kjo rritje i tejkaloi pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar. Indeksi pozitiv që rezultoi pas indeksimit të përgjigjeve të bankave lidhur me kërkesën për kredi, i atribuohet kryesisht kërkesës nga NVM-e, përderisa kërkesa për kredi nga ndërmarrjet e mëdha rezultoi me një indeks negativ marginal. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet, sipas deklaratave të bankave u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, përderisa kërkesa për financimin e investimeve fikse kontribuoi negativisht në kërkesën për kredi. Pritjet për lehtësime të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, zbulimin e vaksinës, si dhe pritjet për realizimin e investimeve të shtyra prej vitit 2020, bankat i pasqyruan në parashikimet e tyre për rritjen e kërkesës për kredi gjatë TM1 2021. Rrjedhimisht, kërkesa pritet të ketë rritje të dukshme për të dy segmentet e ndërmarrjeve, e veçanërisht për NVM-të. Faktorët potencial që mund të ndikojnë në rritjen e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet pritet të jenë nevoja për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, si dhe në një masë të ulët edhe nevoja për financimin e investimeve fikse, faktor ky që prej tremujorit të parë të vitit 2020 ka kontribuar negativisht në kërkesën për kredi.

**Dinamikat e aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese u ndikuan pozitivisht si nga oferta kreditore ashtu edhe nga kërkesa për kredi. Kreditë e reja për këtë segment ekonomik u rritën dukshëm në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare rezultojnë të jenë lehtësuara duke marrë parasysh që masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 ishin lehtësuara në këtë periudhë, mbështetur edhe nga rritja e ardhjeve të diasporës gjatë këtij tremujori. Përkundër prospekteve për rikuperim të aktivitetit ekonomik, bankat presin që lehtësimet të standardeve kreditore për ekonomitë familjare të jenë në një nivel më të ulët krahasuar me këtë tremujor.**

**Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë.** Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kushtet dhe rregullat u lehtësuan kryesisht përmes uljes së normës së interesit, uljes

së kërkesës për kolateral, si dhe në një masë më të ulët përmes rritjes së shumës dhe zgjatjes së maturitetit të kredive. Faktorët kyç që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020 ishin kryesisht rritja e presioneve të konkurrencës, pozita e likuiditetit dhe financimi stabil i sektorit nga burimet e brendshme, si dhe përmirësimi i perspektivës në tregun vendor. Për tremujorin e parë të vitit 2021, bankat deklaruan që presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen deri në një masë. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese.

Masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 të lehtësuara deri në një masë, dërgesat dhe ardhjet e diasporës, si dhe rikthimi deri në një masë i aktivitetit ekonomik u reflektuan në rritje të theksuar të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare në tremujorin e katërt të vitit 2020. Bankat raportuan për rritje më të lartë të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Saktësisht, shtatë nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë, deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi. Bankat raportuan se kjo rritje u ndikua pozitivisht pothuajse nga të gjithë faktorët e listuar në anketë, mirëpo faktori me ndikimin më të lartë ishte perspektiva e favorshme e tregut të patundshmërive, pasuar nga rritja e besueshmërisë së konsumatorëve dhe nevoja për financimin e shpenzimeve tjera. Në tremujorin e parë të vitit 2021, bankat presin rritje të kërkesës për kredi për ekonomitë familjare mirëpo në nivel dukshëm më të ulët se sa në tremujorin aktual. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuuan këto pritje besueshmërisë konsumatore, si dhe nevojës për financimin e shpenzimeve tjera.

**Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ofertën dhe kërkesën kreditore**

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM4 2020	TM1 2021 (pritjet)	TM4 2020	TM1 2021 (pritjet)
<b>Ndërmarrjet</b>	↗	↑	↗	↑
NVM	↗	↑	↗	↑
Ndërmarrjet e mëdha	↗	↑	↘	↑
<b>Ekonomitë familjare</b>	↑	↘	↑	↑
Kredi për blerjen e shtëpive	↑	↘	↑	↑
Kredi konsumuese	↑	↑	↑	↘

↑	Lehtësim i standardeve kreditore (sk)(indeks pozitiv mbi 0.20)
↑	Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
↗	Lehtësim i sk/rritje e kërkesës (indeks pozitiv nën 0.20)
↘	Nuk ka ndryshim (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
↓	Shtyrësim i standardeve kreditore (indeks negativ mbi 0.20)
↓	Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)
↘	Shtyrësim i sk/Rënie e kërkesës (indeks negativ nën 0.20)

Burimi: BQK.

**Pasiguritë rreth prospekteve ekonomike përgjatë vitit 2020, si pasojë e krizës shëndetësore dhe aktiviteteve biznesore të kufizuara rezultuan në pritje për rritje të rrezikut kreditor në vitin 2021 me përfundimin e masave të ndërmarra nga BQK për menaxhimin e efekteve të pandemisë.** Përkundër lehtësimit të masave kufizuese dhe rikthimit të aktivitetit ekonomik të subjekteve ekonomike, si dhe masave lehtësuese të ndërmarra nga BQK për mbështetjen e tyre në tejkalimin e krizës, bankat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese për ekonomitë familjare në tremujorin e katërt të 2020. Sipas pritjeve të deklaruara nga bankat, ky indikator pritet të përkeqësohet tutje në tremujorin vijues kryesisht për kreditë e ndërmarjeve. **Rezultatet e anketës tregojnë që financimi i bankave gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020 u ndikua pozitivisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarjeve, përderisa burimet tjera të financimit nuk patën ndikim të rëndësishëm.** Për dallim nga anketa e kaluar, rezultatet e anketës për periudhën në fjalë tregojnë që financimi i bankave

u rrit në një nivel dukshëm më të lartë, me kontribut dominues nga depozitat e ekonomive familjare. Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin që rritja e qasjes në financim të vazhdojë por në nivel më të ulët se sa në TM4 2020. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të jetë më e lartë se financimi përmes depozitave të ndërmarrjeve. Njëkohësisht, bankat presin mbështetje në financim edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat amë.

## Kutia 1. Metodologjia

### Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë nëntë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë<sup>3</sup>. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

### Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumëzës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

<sup>3</sup> Banka e cila nuk është përfshirë në anketë është Komercialna Banka e cila ka nivel shumë të ulët të kredive dhe atë në formë të linjës kreditore dhe jo ndaj sektorit privat, prandaj dhe nuk është konsideruar të përfshihet në anketë.




## Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

### Kreditë ndaj ndërmarrjeve

#### Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi edhe pse me indeks pozitiv të ulët prej 0.09 paraqesin lehtësim të përafërt me indeksin pozitiv prej 0.08 në TM3 2020. Ndërsa në anketën e kaluar (TM3 2020), bankat kishin deklaruar se presin standarde kreditore të lehtësuara në një nivel më të lartë në TM4 2020 (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks pozitiv prej 0.12 për ndryshimet në standardet kreditore për NVM-të, dhe indeks pozitiv më të ulët prej 0.10 për ndërmarrjet e mëdha. Në këtë lehtësim ndikuan përgjigjet e një banke me rëndësi sistemike dhe një banke me peshë më të ulët të cilat lehtësuan standardet kreditore për të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Rol kryesor në lehtësimin e standardeve kreditore të aplikuara nga bankat në TM4 2020, rezulton të kenë luajtur mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK, përmirësimi i perspektivës në tregjet globale, si dhe lehtësimet rregullative për menaxhimin e efekteve të pandemisë, si ristrukturimi i kredive për shkak të pandemisë Covid-19. Me gjithë deklaratat e bankave për lehtësim të standardeve kreditore, bankat listuan edhe faktorë që ndikuan negativisht edhe pse në nivel të ulët në standardet kreditore, si rritja e rrezikut kreditor në vend dhe jashtë tij. Në linjë me ofertën e lehtësuar, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rritje të dukshme në këtë periudhë, e veçanërisht për NVM-të.

Bankat pritët t'i lehtësojnë edhe më tutje standardet kreditore gjatë TM1 2021, duke u bazuar në pritjet për rimëkëmbjen e ekonomisë në vend, në kombinim me masat lehtësuese të ndërmarrja për menaxhimin e krizës pandemike. Gjashtë nga nëntë bankat pjesëmarrëse, presin që mbështetja e FKGK-së për NVM-të do të ndikojë në lehtësim të standardeve. Gjithashtu, kontribut pozitiv pritët të ketë edhe perspektiva e mirë e tregut bankar në vend, rritja e tolerancës ndaj rrezikut, si dhe në një nivel më të ulët rritja e presioneve të konkurrencës dhe ndryshimeve në rregullore si masa lehtësuese për menaxhimin e krizës. Njëra prej bankave me rëndësi sistemike po ashtu deklaroi se pret kontribut pozitiv deri në një masë në standardet kreditore nga qasja e favorshme në financim nga banka amë.

Konkretisht pesë banka, prej tyre dy me rëndësi sistemike, deklaruan se presin standarde kreditore të lehtësuara për NVM-të, përderisa për ndërmarrjet e mëdha kjo pritje u deklarua nga katër banka.


Rrjedhimisht pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi një indeks pozitiv më i lartë për NVM-të prej 0.34, kurse indeks pozitiv prej 0.23 për ndërmarrjet e mëdha. Njëkohësisht, sa i përket maturitetit bankat pritet të ofrojnë standarde kreditore të lehtësuara për afatet e maturimit, mirëpo për kreditë afatgjata në një nivel më të lartë (indeks pozitiv prej 0.32).

Në linjë me pritjet për standardet kreditore, norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet pritet të ketë rritje të theksuar, saktësisht për NVM-të me një indeks pozitiv prej 0.54, ndërsa për ndërmarrjet e mëdha me një indeks pozitiv prej 0.33.

### Kushtet dhe rregullat

Në TM4 2020, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u lehtësuan mirëpo në një nivel të ulët (grafiku 2). Konkretisht, për NVM-të lehtësimi deri në një masë kishte në normën e interesit dhe madhësinë e kredive të aprovuara ku rezultoi indeks pozitiv prej 0.14 për të dyja kushtet. Kushtet dhe rregullat për kreditë e ndërmarrjeve të mëdha po ashtu u lehtësuan në një nivel të ngjashëm, përmes uljes së normës së interesit, (me indeks pozitiv prej 0.11).

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Faktorët që ndikuan deri në një masë në lehtësimin e kushteve dhe rregullave ishin mbështetja e NVM-ve nga FKGK, si dhe rënia e rrezikut të perceptuar përmes përmirësimit të perspektivës së tregut në vend. Në një nivel më të ulët pozitivisht kontribuan edhe rritja e presioneve të konkurrencës, perspektiva e mirë e tregut bankar dhe lehtësimi i masave të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Njëkohësisht, sipas deklarimeve të bankave përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditore si në vend ashtu edhe jashtë tij ishte faktor që kontribuoi negativisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat gjatë TM4 2020.

Si pasojë e pritjeve për rimëkëmbjen e ekonomisë në vend, bankat gjatë TM1 2021 pritet të aplikojnë ofertë kreditore kryesisht të lehtësuara për ndërmarrjet, duke u bazuar në kushtet dhe rregullat e ofruara. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që presin lehtësime të kushteve dhe rregullave për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, mirëpo lehtësimi në një masë më të madhe pritet të ketë për NVM-të. Për NVM-të, bankat pritet të ulin normat e interesit (indeks pozitiv prej 0.28), të ulin kërkesat për kolateral (indeks pozitiv prej 0.19), si dhe në nivel më të ulët rritje të madhësisë e zgjatje të maturitetit të kredive (indeks pozitiv prej 0.13 dhe 0.15, respektivisht). Për ndërmarrjet e mëdha, bankat kryesisht pritet të ofrojnë shumë më të lartë dhe maturitet më të gjatë deri në një masë (indeks pozitiv prej 0.13 për të dy segmentet). Faktorë me kontribut pozitiv në kushtet dhe rregullat për kreditë e reja dhe me indeks prej 0.36 gjatë TM1 2021, pritet të jetë mbështetja e FKGK-së për NVM-të. Gjithashtu, rritja e presioneve të konkurrencës dhe lehtësimet rregullative për menaxhimin e efekteve të pandemisë janë faktorë tjerë që sipas bankave pritet të ndikojnë në lehtësim të kushteve dhe rregullave gjatë TM1 2021.


## Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rritje edhe pse në nivel më të ulët në krahasim me TM3 2020. Sidoqoftë, rritja e kërkesës për kredi rezultoi të jetë në një nivel më të lartë se sa pritjet e bankave për TM4 2020 të shprehura në anketën e kaluar (TM3 2020) (grafiku 3). Konkretisht, kërkesa për kredi nga NVM-të u rrit me një indeks pozitiv prej 0.19, përderisa kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha kishte një indeks negativ marginal prej 0.07. Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi nga ndërmarrjet e mëdha u ndikua nga përgjigjet e dy bankave me rëndësi sistematike të cilat deklaruan rënie të kërkesës, ku njëra prej tyre deklaroi rënie të konsiderueshme të kërkesës, përkundër që katër prej bankave deklaruan rritje të kërkesës deri në një masë nga ky segment. Rikthimi i aktivitetit ekonomik të sektorëve më të prekur të ndërmarrjeve, si pasojë e lehtësimit të masave të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe nevoja për likuiditet ndikoi që kërkesa për kredi nga ndërmarrjet të ketë rritje.

Sipas anketës, rritja e kërkesës për kredi nga NVM-të kryesisht u ndikua nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues (indeks pozitiv prej 0.19). Përderisa, kërkesa për financimin e investimeve fikse kontribuoi negativisht në kërkesën për kredi me indeks negativ prej 0.28, e që mund t'i atribuohet rënies së kërkesës nga kategoria e ndërmarrjeve të mëdha. Cilësia e aplikacioneve të pranuar kishte përmirësim deri në një masë gjatë TM4 2020 për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, e veçanërisht aplikacionet për kredi nga NVM-të me indeks pozitiv prej 0.22.

Sipas anketës, gjatë TM4 2020 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve ndaj gjithsej kredive kryesisht mbeti i pandryshuar.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Pritjet për lehtësime të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, e rrjedhimisht edhe për aktivitet të rritur ekonomik në vend, bankat i pasqyruan në parashikimet e tyre për kërkesën për kredi gjatë TM1 2021. Rrjedhimisht, kërkesa pritjet të ketë rritje të theksuar për të dy segmentet e ndërmarrjeve, e veçanërisht për NVM-të. Faktorë me kontribut pozitiv në kërkesën për kredi pritjet të jetë nevoja për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, si dhe në një masë të ulët edhe nevoja për financimin e investimeve fikse. Njëkohësisht, bankat presin përmirësim deri në një masë në cilësinë e aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet. Konkretisht, pritjet për cilësinë e aplikacioneve në TM1 2021 janë të përafërta, me një indeks të ulët pozitiv prej 0.10 për NVM-të dhe indeks pozitiv prej 0.17 për ndërmarrjet e mëdha.

Gjithashtu, bankat presin që raporti i kredive jo-performuese të përkeqësohet në TM1 2021 me një indeks pozitiv prej 0.16.


## Kreditë ndaj ekonomive familjare

### Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020 përgjithësisht u lehtësuan në krahasim me tremujorin paraprak me një indeks pozitiv prej 0.21 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe indeks pozitiv prej 0.24 për kreditë konsumuese. Pritjet për tremujorin e katërt të deklaruar nga bankat në anketën e kaluar sugjerorin për lehtësim të standardeve kreditore të aplikuara mirëpo në një nivel më të ulët (grafiku 4). Njëkohësisht, bankat deklaruan të kenë rritur normën e aprovimit të kredive për ekonomitë familjare, dhe atënë një masë më të madhe për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.26 se sa për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.22.

Faktorë që kontribuan pozitivisht në lehtësimin e standardeve kreditore ishin rritja e presioneve të konkurrencës me indeks pozitiv prej 0.37, pasuar nga pozita e kënaqshme e likuiditetit, qasja e favorshme në financim përmes depozitave në tregun e brendshëm, si dhe perspektiva e mirë e bankave amë dhe qasja e tyre në financim me indeks pozitiv prej 0.20.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan




Në tremujorin e parë 2021 bankat presin standarde kreditore të lehtësuara për ekonomitë familjare mirëpo me një indeks pozitiv më të ulët. Standardet kreditore pritet të lehtësohen në një nivel më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, me indeks pozitiv prej 0.22 dhe 0.18, respektivisht. Standardet kreditore pritet të ndikohen pozitivisht nga përmirësimi deri në një masë i perspektivës së tregut në vend, rritja e presioneve të konkurrencës, si dhe lehtësimi i masave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për pezullimin apo reduktimin e aktivitetit në sektor të caktuar ekonomik me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë. Përkundër që nuk është reflektuar në pritjet e përgjithshme për standardet kreditore, bankat kanë deklaruar se deri në një masë përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditore në vend pritet të kontribuojnë negativisht në standardet kreditore gjatë TM1 2021. Njëkohësisht, bankat presin rritje deri të nivelit të aprovimit të kredive, por në nivel më të ulët krahasuar me vlerat aktuale në TM4 2020. Niveli i aprovimit të kredive pritet të rritet në një masë më të madhe për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.26 dhe 0.22, respektivisht.

### Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u lehtësuan në tremujorin e katërt të vitit 2020, edhe pse në nivel të ulët. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat u lehtësuan përmes uljes së normës së interesit (indeks pozitiv prej 0.23 për kreditë për

blerjen e shtëpive dhe 0.11 për kreditë konsumuese), rritjes së madhësisë dhe zgjatjes së maturitetit të kredive (indeks i ulët pozitiv prej 0.13 dhe 0.10 për kreditë konsumuese). Përveç këtyre kushteve dhe rregullave për kreditë për blerjen e shtëpive bankat gjithashtu ulën kërkesat për kolateral me një indeks pozitiv prej 0.15 (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

\* Vlera e pritur

Faktorët që kontribuuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht rritja e presioneve të konkurrencës, pozita e likuiditetit dhe financimi stabil i sektorit nga burimet e brendshme, si dhe përmirësimi i perspektivës në tregun e vendit.

Për tremujorin e parë të vitit 2021, bankat deklaruan se presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen deri në një masë. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kryesisht, të gjitha kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive, përveç ngarkesave tjera të interesit, pritet të lehtësohen deri në një masë. Pritjet për rritjen e shumës së kredisë kanë një indeks pozitiv prej 0.27, pasuar nga zvogëlimi i normës së interesit me indeks pozitiv prej 0.15, si dhe në nivel më të ulët me një indeks pozitiv prej 0.12 pritet janë për zgjatje të maturitetit dhe ulje të kërkesave për kolateral. Përderisa, për kreditë konsumuese, kushtet që pritet të lehtësohen janë ulja e kërkesave për kolateral dhe rritja e madhësisë së kredive me indeks pozitiv të ulët prej 0.16 dhe 0.15, respektivisht. Përderisa, ulja e normës së interesit pritet të ketë një lëvizje të vogël me indeks pozitiv prej 0.12.

### Kërkesa për kredi


Lehtësimi i masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, dërgesat dhe vizitat e diasporës në vend, si dhe ri aktivizimi deri në një masë i aktivitetit ekonomik u reflektuan në rritje të theksuar të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare në tremujorin e katërt të vitit 2020. Bankat raportuan për rritje më të lartë të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Shtatë nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi, ku pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi indeks pozitiv prej 0.50. Kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive kishte një indeks pozitiv prej 0.50, ndërsa për kreditë konsumuese kishte indeks pozitiv prej 0.36. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është dukshëm më i lartë. Për më tepër vlera aktuale e kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive është pothuaj dy herë më e lartë se sa që ishin pritjet e deklaruara nga bankat (grafiku 6).

Kjo rritje u ndikua pozitivisht nga pothuajse të gjithë faktorët e listuar në anketë, mirëpo faktori me ndikimin më të lartë ishte perspektiva e favorshme e tregut të patundshmërive me indeks pozitiv prej 0.31, pasuar nga rritja e konfidencës së konsumatorëve dhe nevoja për financim të konsumit me indeks pozitiv prej 0.27 dhe 0.18, respektivisht. Cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi u përmirësua deri në një masë për të dy llojet e kredive. Saktësisht, cilësia e aplikacioneve nga kreditë

për blerjen e shtëpive u karakterizua me një indeks pozitiv prej 0.28, përderisa për kreditë konsumuese kishte përmirësim mirëpo marginal me indeks pozitiv 0.10.

Bankat deklaruan përqendrim të cilësisë së portfolios kreditore edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me rezultatet e anketës së kaluar. Ndryshimet në cilësinë e portfolios u bazuan në përgjigjet për raportin e kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare me indeks pozitiv prej 0.11 kundrejt indeksit pozitiv prej 0.21 sa deklaruan bankat në anketën e kaluar (TM3 2020).

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Burimi: BQK.

\* Vlera e pritur

Në tremujorin e parë të vitit 2021, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për ekonomitë familjare, mirëpo në nivel dukshëm më të ulët se sa rritja në tremujorin aktual. Bankat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.32, përderisa kërkesa për kredi konsumuese pritet të mos ketë ndryshime të rëndësishme. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuuan këto pritje rritjes së konfidencës së konsumatorëve dhe rritjes së kërkesës për financim të shpenzimeve tjera.

Bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të mbetet e pandryshuar në tremujorin e parë të vitit 2021. Rrjedhimisht, bazuar në përgjigjet e bankave kjo nënkupton që dinamikat në rreziku kreditor pritet të ndikohen nga segmenti i ndërmarrjeve.

Njëkohësisht, bankat deklaruan se presin përmirësim në masë të vogël të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare, veçanërisht për kreditë për blerjen e shtëpive me një indeks pozitiv prej 0.28.

## Financimi


Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve.

Për dallim nga anketa e kaluar, rezultatet tregojnë që financimi i bankave u rrit në një nivel dukshëm më të lartë, ku dominuan depozitat e ekonomive familjare me një indeks prej 0.61. Njëkohësisht, edhe depozitat nga ndërmarrjet kontribuan në financimin e sektorit bankar me një indeks prej 0.51, përderisa burimet tjera të financimit nuk patën ndryshime të rëndësishme (grafiku 7). Dy banka me rëndësi sistematike deklaruan rritje të financimit deri në një masë nga institucionet financiare ndërkombëtare. Megjithatë për shkak të rënies së financimit nga këto institucione të një banke tjetër, kjo komponentë rezultoi me një indeks të marginalizuar pozitiv. Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi kryesor për financim gjatë këtij tremujori me një indeks pozitiv të lartë prej 0.51.

Për tremujorin e ardhshëm, bankat presin që rritja e qasjes në financim të vazhdojë mirëpo në një nivel më të ulët se sa në TM4 2020. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të rritet në

një nivel më të lartë krahas depozitave të ndërmarrjeve, indeks pozitiv prej 0.26 dhe 0.14, respektivisht. Në tremujorin e parë të vitit 2021, dy banka me rëndësi sistemike presin mbështetje në financim të aktivitetit bankar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. Përderisa, dy banka, prej tyre një me rëndësi të përgjithshme sistemike dhe një bankë me peshë të ulët në të gjithësej kreditimin bankar, deklaruan se presin mbështetje në financimin nga banka amë. Sipas maturitetit, në tremujorin e ardhshëm pritet të vazhdoj rritja më e lartë e financimit afatshkurtër me indeks pozitiv prej 0.10 përderisa financimi afatgjatë pritet të mbes i pandryshuar (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Rezultatet e pyetjeve të fokusuara: Ndikimet e Covid-19 në sektorin bankar

Pyetësori i anketës për tremujorin e katërt 2020 është plotësuar me tre pyetje shtesë, me qëllim të vlerësimit të ndikimit të krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 në ofertën dhe kërkesën e përgjithshme kreditore. Gjithashtu, pyetjet adresojnë edhe perceptimin e bankave për rreziqet që janë nxitur nga kriza e shkaktuar si rezultat i përhapjes së virusit Covid-19, dinamikat në rritjen e kreditimit, si dhe efektivitetin e masave lehtësuese të ndërmarra nga institucionet e vendit gjatë kësaj periudhe me qëllim të zbutjes së efekteve të krizës së shkaktuar nga pandemia..

Pyetja mbi rreziqet në rritje, ndaj të cilave ekspozohet direkt sektori bankar ,ka qenë pjesë edhe e kësaj ankete. Ngjashëm me anketat paraprake bankat deklaruan se rreziku kreditor vazhdon të mbetet rreziku kryesor në rritje.ku pritjet janë që ky rrezik potencialisht do të mund të materializohet gjatë vitit 2021. Bankat theksuan se jo materializimi i rrezikut kreditor, deri më tani, i atribuohet masave lehtësuese rregullatore të ndërmarra, si moratoriumi apo shtyrja e pagesës së kësteve të kredisë në periudhën mars – qershor dhe vazhdimi i ristrukturimevepërgjatë vitit 2020. Prandaj bankat presin që me përfundimin e masave në fjalë do të ndjehen efektet e rritjes së rrezikut nga pandemia , dhe atë kryesisht përmes rënies së aftësisë paguese të klientëve me aktivitet në sektorët më të prekur nga kriza pandemike si hoteleria, gastronomia, transporti, e poashtu edhe ndërtimtaria e bujqësia.

Në pyetjen shtesë mbi ndikimin e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike në ofertën për kredi, bankat deklaruan se ndikimi i pakos nuk është reflektuar në standardet e tyre kreditore gjatë TM4 2020. Megjithatë, bankat deklaruan se ndikimet e Pakos në ekonominë e vendit dhe në besueshmërinë e klientëve për kapacitet e tyre për ripagimin e borxheve pritet të vërehen gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, e që rrjedhimisht të mbështetura edhe me rritjen e mbulesës së kredive të garantuara nga FKGK deri në 80 përqind, si pjesë efektive e pakos,do të ndikojnë në aplikim të standardeve më të lehtësuara kreditore. Efekti pritet të reflektohet veçanërisht në sektorët më të prekur nga kriza pandemike.

Ndërsa lejimi i tërheqjes së 10 përqind të kursimeve personale nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, sipas deklarimeve të bankave ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditore

deri në një masë, pasiqë gjatë periudhës së lejimit të tërheqjes së kursimeve është rritur kryerja e obligimeve kreditore të klientëve ndaj bankës. Po ashtu, kjo masë ka ndikuar në lehtësimtë standardeve kreditore për ekonomitë familjare megjithëse në nivel të ulët. Bankat presin që efektet e kësaj mase të vërehen gjatë tremujorit të ardhshëm.

Në pyetjen mbi parashikimin për dinamikat e kreditimit për vitin 2021, bazuar në ecurinë e kreditimit gjatë vitit 2020 dhe zhvillimet me situatën pandemike, bankat deklaruan përgjithësisht sepresin rritje më të lartë të kreditimit se në vitin 2020 mirëpo në nivel më të ulët në krahasim me vitet paraprake. Sipas parashikimit të bankave, norma e rritjes së kreditimit për vitin 2021 pritet të jetë nga 6.0 përqind deri në 10.0 përqind. Parashikimet individuale të bankave ishin asimetrike, ku dy nga bankat parashikuan normë të rritjes së kreditimit prej 20 përqind. Parashikimet e bankave për rritje të kreditimit u i mbështetën në faktorë si ekzekutimi i investimeve të shtyra nga viti 2020, lehtësimi i masave kufizuese ndaj përhapjes së virusit, rritja e aktivitetit ekonomik në vend, zbulimi dhe programi e aplikimit të vaksinës anti-Covid, efektet pozitive të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike dhe masave tjera lehtësuese të aplikuara nga institucionet e vendit. Ndërsa digjitalizimi i shërbimeve, posaqërisht gjatë kësaj periudhe, pritet se do të zgjerojë mundësitë e sektorit bankar për të mbetur profitabil vitet në vazhdim.



## Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar me anketimin e institucioneve financiare depozitare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se këto institucione bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet e çmimeve në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit të realizuar në tetor 2020, përveç deklaramit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2020, pyetësori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e katërt në veçanti dhe për vitin 2020 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

## Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivitetit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. Banka Qendrore e Kosovës, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale dhe në të ardhmen pritet të zgjerohet edhe me agjentë të tjerë ekonomik.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin paraprak si dhe pritjet për vitin aktual dhe tremujorin e ardhshëm. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale. Analiza e pritjeve të inflacionit pritet të jetë pjesë e raporteve të rregullta të BQK-së.

## Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në janar të vitit 2021, bankat kanë vlerësuar nivel më të ulët të inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2020 krahasuar me tremujorët paraprak, ndërsa për tremujorin e parë të vitit 2021, bankat kanë deklaruar të presin një ngritje të shkallës së inflacionit nga 0.2 përqind në TM4 në 0.5 përqind. Për vitin 2021, bankat presin që niveli i inflacionit do të arrijë në 0.9 përqind, nga 0.2 përqind sa ishte në vitin 2020 (tabela 1). Anketa e realizuar përfshinë edhe

efektet potenciale që presin bankat pas përballjes me gjendjen e re të paprecedent të shkaktuar nga pandemia Covid-19.


Tabela 1. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM4 2020	TM1 2021	2021
1	0.4%	0.6%	1.1%
2	0.1%	0.9%	1.2%
3	-0.3%	0.1%	0.3%
4	-0.1%	0.3%	0.7%
5	0.2%	0.3%	1.2%
6	-0.2%	0.3%	-0.2%
7	0.2%	0.5%	1.5%
8	1.1%	1.1%	1.1%
9	0.2%	0.4%	0.7%
<b>Mesatarja</b>	<b>0.2%</b>	<b>0.5%</b>	<b>0.9%</b>

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në tre muajt e parë të vitit ishte rreth 0.6 përqind, ndërsa në TM4 2020, është shënuar deflacion prej 0.1 përqind, duke sugjeruar për pritje mirë të bazuara të bankave për periudhën. Pothuajse të gjitha bankat presin që inflacioni do të jetë nën nivelin prej 1 përqind, me përjashtim të një banke që pret se inflacioni do të jetë më i lartë se 1 përqind në tremujorin e parë të vitit 2021. Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë një pasiguri relativisht të ulët në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM4 2020 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë cituar disa faktorë të mundshëm për nivelin e inflacionit:

- ✓ Rritjet e rasteve të infeksioneve me Covid-19 do të përkthehen në rënie të aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht, në kërkesë të dobësuar në vend, duke ndikuar kështu në presione të dobësuar inflacioniste. Kundër-efekt në këtë dinamikë mund të shkaktoj shkëputja në zinxhirin të furnizimit, duke ndikuar potencialisht në rritje të çmimeve (sidomos ato të ushqimit);
- ✓ Çmimet e energjisë parashihet të mbesin të ulëta për një kohë më të gjatë;
- ✓ Faktor përcaktues për dinamikën në çmime në vend mbesin edhe shkalla e ulët e prodhimit dhe varësia e lartë nga importet – rrjedhimisht zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare;
- ✓ Për dallim nga viti 2020, bankat janë deklaruar më optimiste kundrejt pandemisë për vitin 2021, dhe presin rritje të aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht të nivelit të inflacionit.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web:www.bqk-kos.org